



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI DHE KRYENEGOCIATOR

**RAPORTI I KONSULTIMIT PUBLIK TË PLANIT KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN
EVROPIAN 2023-2025 (PKIE 2023-2025)**

1. Titulli i projekt-aktit

Vendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2023-2025 (PKIE 2023-2025)”.

PKIE 2023-2025 do të shërbejë si instrument i planifikimit dhe monitorimit të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe i procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. PKIE 2023-2025 synon prioritizimin, planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e përafrimit të plotë të legjislacionit shqiptar me *acquis*-in e Bashkimit Evropian si një nga kriteret e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Gjithashtu PKIE 2023-2025 është plani i përafrimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, por jo vetëm. PKIE-ja është edhe plani i përafrimit të standardeve të BE-së, nëpërmjet dokumenteve strategjike legjislative, si dhe i masave zbatuese, institucionale/administrative/financiare, të legjislacionit të përafuar, në funksion të ecurisë së negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Masat zbatuese mbështetëse, të tilla si përkthimi i legjislacionit, trajnimet, forcimi i kapaciteteve administrative (shtesa të personelit, etj.), investimet, logjistika, etj., do të përfshihen gjithashtu në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Konsultimi publik i projektvendimit të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit kombëtar për Integrimin Evropian 2023-2025” ka patur një kohëzgjatje 20 ditë pune nga momenti i shpalljes në regjistrin elektronik të konsultimeve publike.

3. Metodat e konsultimit

Për konsultimin publik të PKIE 2023-2025 u përdorën metodat si më poshtë:

- Konsultimi publik nëpërmjet regjistrit elektronik të konsultimeve publike

- Takim për konsultimin e kapitullit “Kriteri Politik” dhe kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, me tryezën e diskutimit dhe këshillimit pranë GNPIE kapitulli 23, të ngritur në kuadër të Platformës së Partneriteti Publik për Integrimin Evropian.

Sikurse është përmendur dhe më lart konsultimi publik i projektvendimit të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit kombëtar për Integrimin Evropian 2023-2025” ka patur një kohëzgjatje 20 ditë pune nga momenti i shpalljes në regjistrin elektronik të konsultimeve publike. Projektakti u shpall në regjistër për konsultim në datë 29.12.2022 dhe afati i fundit për komente/sugjerime ishte data 26.1.2023. Konsultimi publik për PKIE 2023-2025 në regjistrin elektronik të konsultimit publik të projektakteve ishte një konsultim i hapur për çdo individ apo organizatë e interesuar për procesin e integritetit Evropian për të dhënë mendim apo sugjerime mbi projektaktin. Gjatë periudhës të konsultimit në regjistrin e konsultimit publik të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2023-2025, ka patur 2 komente, ku njëri koment i përket fushës së mjedisit dhe komenti tjetër është në kuadër të mbështetjes financiare që Bashkimi Evropian i jep vendit tonë.

Ministria e Drejtësisë në kuadër të procesit të konsultimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2023-2025, në bazë të metodologjisë për hartimin e këtij plani, Urdhrit të Kryeministrit Nr. 113, datë 30.8.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian” si dhe në përputhje me Ligjin Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, në cilësinë e institucionit lider për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” dhe Kriterit Politik më datë 25 janar 2023 në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë zhvilloi procesin e konsultimit të PKIE 2023-2025 për këta kapituj nën drejtimin e Kryetares së GNPIE-së dhe Negociatore, Znj. Adea Pirdeni, Zëvendësministre e Drejtësisë.

Në takimin e zhvilluar për procesin e konsultimit të PKIE 2023-2025 për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” dhe “Kriterin Politik” me anëtarët e PPIE në Ministrinë e Drejtësisë, morën pjesë 4 përfaqësues gjithsej nga organizata të shoqërisë civile si dhe të botës akademike. Anëtarët e tryezës së diskutimit dhe këshillimit GNPIE kapitulli 23, nuk kishin komente për masat ligjore dhe zbatuese të planifikuara për kapitullin 23 si dhe për pjesën analitike për këto kapituj. Por kërkuan disa informacione shtesë dhe sqaruese për sa i përket fazës në të cilën është krijimi i regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse, fuqizimit të kapaciteteve të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion, si dhe digjitalizimit të arkivës gjyqësore.

4. Palët e interesuara të përfshira

Në regjistrin e konsultimit publik u regjistruan dy komente. Njëri nga komentet vinte nga Instituti i Politikave Mjedisore dhe tjetri nga Z. Koço Broka. Nga takimi i mbajtur për konsultimin e PKIE 2023-2025 me tryezën e diskutimit dhe këshillimit GNPIE kapitulli 23, ka patur 3 komente nga përfaqësuesit e grupeve të interesit.

Nga procesi i konsultimit të PKIE 2023-2025 me përfaqësuesit e grupeve të interesit u mblodhën këto komente:

| Çështja e adresuar | Komenti | Palët e interesuara | Vendimi | Arsyetimi |
|--------------------|--|----------------------------------|---|--|
| Mjedisi | <p>Instituti i Politikave Mjedisore përcjell komentet për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2023-2025 (PKIE 2023-2025), duke sugjeruar së pari se, në përgjithësi, nevojitet më shumë legjislacion i përafuar në fushën e mjedisit, kapitulli 27. Së dyti, ligji evropian për klimë (https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32021R1119&qid=1674301480982&from=EN) parashikon arritjen e qëllimeve të Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane, që ekonomia dhe shoqëria e Evropës të bëhen neutrale ndaj klimës deri në vitin 2050.</p> <p>Ky ligj përcakton gjithashtu objektivin e ndërmjetëm të reduktimit të emetimeve neto të gazeve serrë me të paktën 55% deri në vitin 2030, krahasuar me nivelet e vitit 1990. Duke qenë se Shqipëria po synon integrimin e saj në BE, përpjekjen për reduktimin e emetimeve duhet të jenë në unison me BE-në në legjislacion dhe për rrjedhojë, edhe në zbatimin praktik. Në këtë kontekst, Instituti i Politikave Mjedisore, përcjell sugjerimin për adoptimin dhe përshtatjen e këtij legjislacioni në legjislacionin Shqiptar si ligj dhe si</p> | Instituti i Politikave Mjedisore | Asnjë ndryshim në dokumentin e PKIE 2023-2025 | <p>Komenti i dhënë nga Instituti i Politikave Mjedisore nuk mund të përfshihet në PKIE 2023-2025, pasi ka karakter të përgjithshëm.</p> <p>Për sa i përket përafrimit të legjislacionit të kërkuar në koment, sqarojmë se si një vend kandidat që ka filluar negociatat e anëtarësimit, Shqipëria është tërësisht e angazhuar që të përafrojë plotësisht legjislacionin e saj me <i>acquis</i>-in e Bashkimit Evropian dhe ta zbatojë legjislacionin e përafuar si një detyrim që rrjedh nga marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe nga procesi i anëtarësimit. Realizimi i këtij angazhimi kërkon instrumente dhe mjete të përmirësuara për planifikimin, zbatimin, monitorimin, raportimin dhe</p> |

| | | | | |
|----------------------|--|---------------|----------------|---|
| | <p>dokument strategjik, i përshtatur, nën institucionin propozues, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Duke qenë se Shqipëria nuk është vend anëtar lidhur me Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane, përshtatja sugjerohet të bëhet me dokumentin e nënshkruar edhe nga shteti Shqiptar në Samitin e Sofjes, Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor (AGJBP). Për këtë mund të nevojitet edhe bashkëpunimi me <i>Regional Cooperation Council</i> që po zhvillon planin e veprimit të AGJBP-së.</p> | | | <p>vlerësimin e zbatimit të <i>acquis</i>-it. Gjithashtu sjellim në vëmendje se kapitulli 27 “Mjedisi dhe ndryshimet klimatike” ka një kosto të lartë financiare, dhe për këtë arsye edhe shtetet anëtare, siç mund të përmendim rastin e Kroacisë, kanë kërkuar periudha tranzitore për zbatimin e angazhimeve që rrjedhin nga ky kapitull.</p> <p>Komentet dhe problematikat e tjera të ngritura janë pjesë e agjendës së Stabilizim-Asociimit, të cilat trajtohen dhe raportohen në mekanizmat e ngritura për monitorimin e agjendës së SA-së, si dhe një pjesë e tyre i takojnë marrëdhënieve ndërkombëtare në kuadër të marrëveshjes së <i>Green Agenda</i>.</p> |
| Çështje që lidhen me | Ky dokument të shoqërohet me publikimin e mbështetjes | Z. Koço Broka | Asnjë ndryshim | Në lidhje me këtë koment/sugjerim, |

| | | | | |
|--|---|-------------------------------|---|---|
| mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian | financiare të Bashkimit Evropian për vendin tonë, strukturën e saj, sa është vlera e kësaj mbështetjeje gjithsej, e ndarë kjo për asistencë teknike, për investime, për mbështetje buxhetore etj., sipas klasifikimeve përkatëse, sa ka qenë ajo në vitet para hapjes së negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë në BE, në korrik të vitit 2022 dhe sa pritet në vitet më pas, si p.sh. për vitin 2023 e ato në vijim!? | | në dokumentin e PKIE 2023-2025 | sqarojmë se informacioni i kërkuar për të qenë pjesë e PKIE-së 2023-2025, i përket fushës së veprimit të Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës (SASPAC). Ky informacion është objekt i dokumenteve të tjera strategjike siç janë planet e veprimit në kuadër të projekteve IPA, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. |
| Kriteri Politik, “Shoqëria Civile” | Në çfarë faze është krijimi i regjistrimit elektronik të organizatave jofitimprurëse? | Lëvizja Evropiane në Shqipëri | Asnjë ndryshim në dokumentin e PKIE 2023-2025 | Për sa i përket pyetjes së përfaqësueses së EMA, regjistri është në fazën e implementimit. Konkretisht është ngritur infrastruktura ku do të hostohet sistemi elektronik dhe po vijohet me dizenjimin e sistemit sipas formularëve të miratuar, si dhe po mundësohet ndërveprimi automatik më të gjithë |

| | | | | |
|---|--|---|---|---|
| | | | | institucionet që përfshihen. |
| Kapitulli 23 “Lufta kundër korrupsionit” | Çfarë nënkupton dhe si do të realizohet fuqizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit? | IDRA (Institute for Development, Research and Alternatives) | Asnjë ndryshim në dokumentin e PKIE 2023-2025 | Fuqizimi i DPA do të realizohet nëpërmjet plotësimit të strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit si dhe trajnimeve të stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, të cilat janë edhe masa zbatuese të parashikuara në PKIE 2023-2025. |
| Kapitulli 23, “Gjyqësori” | A do të ndërmerret ndonjë masë për digjitalizimin e arkivës gjyqësore? | Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë | Asnjë ndryshim në dokumentin e PKIE 2023-2025 | Në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2023-2025 është parashikuar si masë zbatuese Ndërtimi i sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve dhe nuk ka të parashikuar masë ligjore ose masë zbatuese në lidhje me digjitalizimin e arkivës gjyqësore por do të mbahet në konsideratë për tu diskutuar në të ardhmen. |